

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Rikonstrukcion i linjës Fier-Kafaraj dopio qark dhe trakt i ri linje 110 kV në N/St. Fier”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31321100-3- Linja ajrore të energjisë elektrike.

VLERA E FONDIT LIMIT:

264,316,049 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyzet e nëntë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 260,000,000 (dyqind e gjashtëdhjetë milion) Lekë.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhironja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të balanceve ku të paktën në dy balance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros duhet te jete ne masen 260,000,000 (dyqind e gjashtëdhjetë milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 130,000,000 (njëqind e tridhjetë milion) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 500,000,000 (pesëqind milion) lekë pa TVSH.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shenim: Kontrata të ngjashme persa i perket punimeve elektrike për vete specifiken që kanë, do të konsiderohen punimet në Linjat elektrike dhe Nënstacionet elektrike me nivel tensioni ≥ 110 kV.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, si dhe punimet e kërkuara, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë sipas parashikimeve ligjore. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Gjithashtu, duke patur në vëmendje punën e vështirë dhe llojin e vecantë që duhet të bëjë OE në realizimin e kësaj kontrate, AK kërkon me doemos që OE ofertues t’i ketë një përvojë të ngjashme të kësaj natyre.

Përsa i përket cilësimit të kontratave të ngjashme, sipas opinionit teknik të inxhinierëve të AK gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, sqarojmë se Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. administron rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike me tension 110-400 kV, që përbëhet nga nënstationet 400/220 kV, nënstacione 110/TM kV dhe linjat 110/220/400 kV.

Për të garantuar funksionimin normal dhe të sigurtë të sistemit elektro-energjetik, OST sh.a. ka për detyrë zhvillimin, automatizimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen e komponentëve të Sistemit të Transmetimit.

Thëksojmë se, OST sh.a. është institucioni i vetëm menaxhues i objekteve me këto nivele tensioni.

Garantimi i qëndrueshmërisë të Sistemit Energjetik si dhe siguria e furnizimit me energji elektrike në tensionet e larta bazohet në zbatimin e rreptë të rregulloreve të Sigurimit Teknik dhe të Shfrytëzimit Teknik të Nënstacioneve dhe Linjave të Sistemit Energjetik.

Për të bërë një krahasim të nivelit teknik/profesional të kërkuar në punimet në pajisjet e tensionit të lartë argumentojmë si vijon për punimet me nivel tension 110, 220 dhe 400 kV:

- Rrjetet 110, 220 dhe 400 kV, administruar nga OST sh.a. janë të ndërtuar në ajër (AIS) pra, përdorin qëndrueshmëri elektrike të ajrit si material izolues. Ato kërkojnë sipërfaqe të madhe dhe në shumë raste punime në hapësira që janë afër pajisjeve nën tension të lartë që paraqesin rrezikshmëri të lartë për operatorët. Puna e tyre mbikëqyret dhe kushtëzohet nga kërkesat e rregulloreve të sipërpërmendura. Në nënstacion/linja mund të punojnë vetëm operatorë të instruktuar dhe me kartelë të sigurimit teknik.
- Pajisjet primare vendosen në bazamente betoni të armuar dhe konstruksione mekanike të veçanta. Theksojmë që pajisjet primare janë të rënda dhe njëkohësisht tepër delikate. Ato kërkojnë makina ngritese/transportuese si dhe rrespektimin e rregullave të veçanta për transportin, lëvizjen, vendosjen në bazament dhe montimin.
- Punimet për kabllimin, testimin, komisionimin e tyre, të cilat kryhen për secilin element kanë nevojë për operatorë shumë të specializuar për shkak të vështirësive, kompleksitetit të punimeve dhe kanë një kosto relativisht të madhe.
- Mbrojtja rele është një pajisje komplekse që shfrytëzon të dhëna të kombinuara (rryme/tension) dhe mbrojtje rryme, të cilat kabllohen duke krijuar llogjika për bllokime elektrike për mosveprim në rast veprimesh të gabuara. Mbrojtjet rele dhe automatika (BCU) vendosen në panele të veçanta.
- Për testimin dhe komisionimin e saj ndiqet një procedurë e standardizuar IEC. Kompleksiteti i punës në to kërkon gjithashtu punonjës me specializim të lartë dhe njohuri të thella për pajisjet.
- Matja vendoset në panele të veçantë dhe ndiqet një procedurë e standardizuar testimi që është e rregulluar nga norma të rrepta IEC. Operatorët janë tepër të specializuar.
- Në një nënstacion bëhen punime për SKADEN dhe Telekomunikacionin që kërkojnë njohje të pajisjeve dhe specializim të lartë të operatorëve dhe kompanive që punojnë.
- Punimet për ndërtimin/rikonstruksionin/punimet e linjave të tensionit të lartë kanë vështirësi që lidhen me projektimin, ndërtimin, vendosjen e shtyllave, përcjellësve dhe elementeve të ndryshëm përbërës të saj. Ndërtimi i një linje të tensionit të lartë kërkon makina dhe pajisje speciale pa të cilat kompromentohet seriozisht cilësia e punimeve për ndërtimin e tyre. Ndërtimi i linjave të tensionit të lartë kërkon kushte teknike të veçanta dhe shumë të rrepta pasi ato ju nënshtrohen kushteve atmosferike tepër të rënda dhe duhet të paraqesin qëndrueshmëri të mjaftueshme mekanike ndaj tyre.
- Mund të pohojmë se, kompleksiteti, vështirësia dhe rëndësia e punimeve të sipërpërmendura rritet me rritjen e nivelit të tensionit (ndryshimi mes 110, 220 dhe 400 kV dhe niveleve të tjera më të ulëta të tensionit) dhe përcakton në mënyrë domethënëse edhe kërkesat për nivelin profesional të operatorëve që do të kryejnë ato si dhe përdorimin e makinave dhe pajisjeve.

Theksojmë se: në përcaktimin e kushteve për punime në objektet e OST sh.a., përveç rregulloreve tona, është marrë si model edhe procedura dhe kërkesat teknike të ndjekura nga Kontraktorë të

huaj shumë të njohur dhe me eksperiencë që kanë punuar në objektet tona prej më shumë se 15 vite.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me licence profesionale në fushën e projektimit ose të ketë marrveshje kontraktuale me disponuesit e këtyre licencave, leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

<i>Projektues konstruktor</i>	<i>- Pika 3/b</i>
<i>Projektues instalator</i>	<i>- Pikat 4/c</i>
<i>Projektues gjeodet</i>	<i>- Pikat 8/a, d</i>
<i>Studim gjeologjiko inxhinierik - hidrogeologjik</i>	<i>- Pikat 9/b, d</i>
<i>Projektim impianteve ... të shpërnd. en. elektrike</i>	<i>- Pika 10/ d</i>

Argumentimi: Këto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak, specifikimet teknike dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktojë disponuesit e këtyre licencave, nëse nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues ose personi fizik apo juridik që disponon licencat e projektimit dhe që ka marrveshje kontraktuale me ofertuesin për realizimin e projektit, duhet të disponojë:*

- a) *Program të licencuar “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashëm;*
- b) *Të pakten 1(një) Inxhinier Elektrik të certifikuar për përdorimin e programeve “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashme për realizimin e projektit të linjes, i cili të figurojë në listpagesa të pakten 12 muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Lidhur me inxhinierin elektrik të kërkuar me sipër, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për punonjeshin e sipërcituar: kontratën individuale të punës, shoqëruar me diplomën përkatëse, certifikimin për përdorimin e programeve “PLS CADD and TOWER” ose të ngjashme, si dhe listepagesat për periudhën e kërkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte e domosdoshme pasi OST disponon licenca dhe perdor per projektimin e linjave softin PLS – CADD dhe shtyllat me PLS – TOWER. Ne menyre qe te analizohet lehtesisht projekti i hartuar nga kontraktori pervec dokumentacionit me ralcionin e printuar do te kerkohet dhe nje kopje elektronike e projektit ne CD. Kjo do te jete ne formatin “.bak” dhe me pas do te ekstraktohet nga stafi teknik i OST per te kontrolluar projektin e linjes e paraqitur per aprovim, llogaritjet e shtyllave ngarkesat mekanike dhe kriteret me koheficientet e sigurise se aplikuar.

Gjithashtu ne menyre qe te mos kete kufizim tregu ne ofertim eshte lene mundesia dhe per aplikacione te tjera te ngjashme mjafton qe kopja elektronike e projektit te jete ne formatin “.bak” file ne menyre qe projekti te jete i lexueshem nga softet i instaluar ne kompjuterat e OST sh.a.

Por eshte e domosdoshme qe nje operator ekonomik ose personi qe do te hatoje projektin te kete nje licencim ose trajnim personal qe deshmon kapacitet teknike dhe aftesine ne perdorimin e ketij softi apo softeve ekuivalente.

Me ane te softit PLS CADD ndertohet profili gjatesor, llogariten varjet e percjellesit, behet shtyllezimi i linjes, nxirren ngarkesat e strukturave nga percjellesit dhe modelohen shtyllat. Per kete arsye eshte e nevojshme qe punonjesi qe do te pergatise projektin e linjes te jete inxhinier elektrik.

Ky është një kriter i nevojshëm dhe i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim për të vërtetuar kapacitetet e ofertuesit mbi realizimin me suksese të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky aplikacion sherben dhe eshte i lidhur ngushtesisht me realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi. Ky aplikacion nuk e kufizon konkurrencen per shkak se mund te blihet lehtesisht nga OE ofertues.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorite e meposhtme:

Punime te përgjithshme/speciale ndertimi:

<i>Kategoria NP-1</i>	<i>Punime germimi ne toke</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NP-2</i>	<i>Ndertime civile dhe industriale</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NP-11</i>	<i>Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e te mesem dhe shperndarjen e energjiise</i>	<i>Klasifikimi E</i>
<i>Kategoria NS-1</i>	<i>Punime per prishjen e ndertimeve</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NS-13</i>	<i>Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NS-18</i>	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Klasifikimi A</i>

Shenim:

- i. *Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.*

Argumentimi: Keto kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe te lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht punonjesit si me poshte vijon:*

- ➤ *Si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier ndertimi, 1 (nje) inxhinier elektrik, 1 (nje) inxhinier mekanik, 1 (nje) inxhinier topograf/Gjeodet, 1 (nje) inxhinier elektronik, 1 (nje) inxhinier mjedisi, 1 (nje) inxhinier gjeolog. Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 12 (dymbedhete) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*
- ➤ *Gjithashtu si pjese e stafit te Tij ofertuesi pervec inxhiniereve te mesiperm duhet te kete dhe 2 (dy) inxhinier elektrik dhe 1 (nje) inxhinier ndertimi. Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 12 (dymbedhete) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje per punonjesit e sipercituar: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperm, licensen e shoqerise si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinierët e sipercituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë

23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjesve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri i punonjesve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 45 (dyzet e pese) punonjes për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim të leshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjesve të siguruar, shoqeruar me listëpagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjesve është përlogaritur duke patur në konsideratë volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 20 (njëzet) punonjes, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, nga të cilët 10 (dhjetë) të jenë punonjes me kategorinë e sigurimit teknik IV-V, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- i) listëpagesat E-Sig të punonjesve të sipërcituar si dhe*
- ii) kartelat perkatese të vlefshme të sigurimit teknik.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për personelin e pajisur me kartelat e sigurimit teknik, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë kartelat përkatëse të punonjësve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numer i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe çdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Punonjesit që do të realizojnë këto kontrate, për arsye të natyrës teknike të saj dhe kushteve të punës në linjat e tensionit të lartë, duhet të respektojnë rregulloren e sigurimit teknik elektrik, bazuar në dispozitat ligjore përkatëse për punimet mbi 1000 Volt, në lartësi, me heqje dhe pa heqje tensioni, duke rrespektuar largësinë me tensionin nominal të punës për linjat 110 kV e lart.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 1(një) punonjës, të trajnuar dhe të pajisur me certifikate për përdorim Makineri shtrirje + terheqje dhe frenim percjellesi (percj., tros, opgw) 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Lidhur me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë: kontratat individuale të punës, shoqëruar me certifikatën si dhe listepagesat për periudhën e kërkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për këto punonjës është e lidhur ngushtesisht me realizimin e kontratës objekt procedure prokurimi, shtrirje + terheqje dhe frenim percjellesi (percj., tros, opgw). Kjo punë e posaçme kërkon certifikim dhe experience, në mënyrë që most e shfaqen problematika dhe vonesa në realizimin e kontratës. Kjo kërkesë për kualifikim është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës, sipas objektit të saj.

2.3.9 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te pakten 15 (pesembedhjetë) punonjes te certifikuar per punime ne lartesi ku njeri prej tyre te jete inxhinier i trajnuar dhe i pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me rrisht te larte, te cilet duhet te jene te siguruar jo me pak se 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me, certifikatat si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me stafin teknik te certifikuar per punime ne lartesi, argumentohet se realizimi i punimeve objekt kontrate kerkon punonjes qe kane aftesite fizike dhe teknike per te punuar ne kushte te veshtira pune, ne shtylla tensioni te larte dhe ne lartesi nga toka.

Persa i perket kerkeses per nje inxhinier te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me rrisht te larte, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate zbatimit te kontrates objekt prokurimi, ne perputhje me Ligjin Nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.10 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 1(nje) Inxhinier elektrik te certifikuar per: arkitekturen dhe skemat e Nenstacioneve elektrike te TL; mbrojtje dhe komandime; Scada/RTU dhe rele, te cilet duhet te jene te siguruar jo me pak se 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqerua me diplomat e Inxhinierve elektrik, certifikatat si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinierin e sipërcituar është e lidhur me objektin e kontratës dhe natyrën e profilit të inxhinierit elektrik, si dhe në mbështetje me natyrën specifike që kanë këto pjesë të rëndësishme të kontratës objekt prokurimi. Kjo kërkesë për kualifikim është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.11 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

Nr.	Mjetet	Sasia
1	Eskavator me goma, kova 0.25 m ³	1 cope
2	Fadrome	1 cope
3	Autobetoniere	2 cope
4	Autovinc me kapacitet mbajtes mbi 5 ton	1 cope
5	Kamicina me kapacitet mbajtes mbi 1.5 ton	2 cope
6	Motoarganella	2 cope
7	Vinc tip falkone (pa motoarg.)	2 cope
8	Makineri terheqje-leshuese percj.,tros, opgw	1 set
9	Prese Hidraulike e moterizuar	2 sete
10	Instrument për matjen e dispresionit kromatik me shtrirje dinamike min 55 db	1 cope

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të disponojë:

- 1. Për mjetet, makinerite dhe pajisjet në pronësi të paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)*
- 2. Për mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje (ose formë tjetër huaje) si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit të bere me lart. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve.*
- 3. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi) dhe akti i kolaudimi.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Mjetet dhe pajisjet teknike të vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjatë realizimit të kontratës objekt procedure prokurimi, për

realizimin e punimeve që do të kryhen në kantier. Kjo kërkesë është minimale dhe jodiskriminuese në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe pika 6/d, të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrata, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a. ISO 9001: certifikaten e menaxhimit të cilësisë së punimeve, që ka lidhje me objektin e kontratës;*
- b. ISO 45001: certifikaten e sistemit të menaxhimit të sigurisë në punë, që ka lidhje me objektin e kontratës;*
- c. ISO 14001: për sistemin e menaxhimit mjedisor, që ka lidhje me objektin e kontratës.*
- d. ISO 27001: për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, që ka lidhje me objektin e kontratës.*
- e. ISO 50001: Për sistemin e menaxhimit të energjisë*

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare, të objektit të kontratës.

Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohej nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të vecantë për kryerjen e kësaj kontrate. OE ofertues që do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi duhet të kryejë punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet që mund të shfaqen gjatë realizimit të kësaj kontrate.

Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001: e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues është i certifikuar për produkte të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Certifikata e menaxhimit te sigurise se informacionit ISO 27001: eshte e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit. Per shkak te rendesise se veçante që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht ne sistemin elektro-energjitik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur dhe Kontraktori objekt procedure prokurimi, duhet te nderhyje ne sistemin e brendshem te AK. Certifikimi sipas kesaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve te OE ofertues dhe i jep sigurine e nevojshme AK.

Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001: është e nevojshme si kriter kualifikues, pasi lidhet me natyrën e kontratës, veprimtarine dhe perdorimin e pajisjeve per te cilat duhet te kete nje siguri qe nuk shperdoroje energjine e nevojshme gjate realizimit te punimeve. Me ane te ketij certifikimi, identifikohen dhe menaxhohen rreziqet që lidhen me furnizimin e ardhshëm të energjisë, mundesohet matja dhe monitorimi i përdorimit te energjisë për të identifikuar se ku të përmirësohet efikasiteti. Po ashtu do te përmirësohet performanca e përgjithshme për të ulur konsumin e energjisë, etj.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.13 Operatori ekonomik ofertues duhet te plotesoje saktesisht kolonen me te dhenat teknike te ofertuar ne te gjitha tabelat e paraqitura ne Shtojcen 5 (Specifikimet teknike) te ketyre DT-ve, ku kerkohet.

Mosplotesimi i sakte eshte element skualifikimi.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njeh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në proceduren objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

2.3.14 Per listen e meposhtme te mallrave:

- 1. Shtylla metalike 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
- 2. Percjelles ACSR 240/40 mm², sipas specifikimeve teknike.*
- 3. Tros OPGW, sipas specifikimeve teknike.*
- 4. Joint Box, sipas specifikimeve teknike.*
- 5. Pajisje Bay Unit, sipas specifikimeve teknike.*
- 6. Celes SF6 110 kV (tre fazor), sipas specifikimeve teknike.*
- 7. Ndares me nje thike toke 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*

8. *Ndares pa thike toke 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
9. *Ndares me dy thikja toke 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
10. *Transformator rryme 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
11. *Transformator tensioni 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
12. *Shkarkues 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
13. *Izolator mbështetës 110 kV, sipas specifikimeve teknike.*
14. *Konstruksione metalike te përbëra, sipas specifikimeve teknike.*
15. *Pajisje telekomunikacioni multiplekser hibrid STM-4/16 & MPLS-TP me module transmetimi optik, module kontrolli, module switching Ethernet, module teleaksioni, module telefonie, module MPLS-TP, License HYBRID SDH MPLS-TP, License NMS, sipas specifikimeve teknike.*

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

1. *Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze.*

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese te katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

Argumentimi: Në lidhje me kriterin për listën e mallrave që do të përdoren, nisur nga rëndësia e madhe e projektit dhe funksioni që ato do të kryejnë në realizimin e objektit të kontratës, si dhe nga vlera e tyre, u mendua që ky kriter të mundësojë sigurimin e mallrave cilësore me parametra që plotësohen nga prodhues të certifikuar për menaxhimin e cilësisë së mallrave. Ky kriter është në proporcion me vlerën e kontratës, është jodiskriminues dhe i mundshëm të përmbushet nga cdo operator që ka përvojë në këtë fushë objekt kontrate.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.15 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Ames, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratores te shoqerise,*

Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punimet objekt procedure prokurimi, duke përfshirë sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.